

TERMAT E REFERENCËS PËR AUDITORËT NR. REFERENCE [FB-HKFR-2025-020]

QËLLIMI I SHËRBIMIT: AUDITIMI I RAPORTIT FINANCIAR VJETOR TË HANDIKOS FERIZAJ

Departamenti financiar i Handikos Ferizaj përgatit çdo vit një raport financiar vjetor për transparencë ndaj donatorëve e i cili bazohet në të dhënat dhe informacionet e siguruar nga sistemi i kontabilitetit të Handikos Ferizaj. Është kërkesë që ky raport, që mbulon periudhën **01.01.2024 – 31.12.2024**, të auditohet nga një auditor i pavarur dhe i licencuar (“auditori”), i cili ka kompetencën dhe përvojën profesionale të nevojshme. Auditori pritet të shpjegojë dhe të sqarojë çdo rregullim dhe/ose klasifikim të ri të bërë në raport.

Parimet e përgjithshme të auditimit

Auditori kërkohet të planifikojë, ekzekutojë dhe raportojë mbi angazhimin e auditimit në mënyrë që të formojë një vlerësim profesional mbi çështjet e mëposhtme që lidhen me aktivitetet e Handikos Ferizaj:

- Parimet e rregullsisë (rregullsia financiare)
- Ekzistenca, mjaftueshmëria dhe efektiviteti i Sistemit të Kontrollit të Brendshëm.
- Pajtueshmëria me objektivat e projektit dhe respektimi i kushteve të kontratës
- Administrimi ekonomik i aktivitetit dhe përdorimi efektiv i burimeve financiare

Dokumentet e referencës

Dokumentet dhe çështjet e mëposhtme duhet të merren në konsideratë nga auditori si referenca bazë për kryerjen e rishikimit financiar:

1. Raporti Financiar
2. Raporti Financiar Vjetor i përgatitur nga Handikos Ferizaj për vitin 2024.
3. Rregullat dhe rregulloret
4. Rregullat dhe rregulloret e brendshme të Handikos Ferizaj.
5. Projektet/Programet
6. Marrëveshjet, kontratat dhe dokumentet e projekteve të nënshkruara me donatorë dhe partnerë që mbulojnë vitin financiar 2024;
7. Buxhetet që mbulojnë periudhën 01 janar deri më 31 dhjetor 2024, planet e financimit dhe programet e aktiviteteve të projekteve të Handikos Ferizaj;
8. Çdo dokument tjetër që lidhet me projektet/programet, si raportet e misionëve të ekspertëve.

Kontabiliteti

- Regjistrimet kontabël dhe dokumentacioni mbështetës.
- Dokumentet kontabël që do të jenë subjekt i auditimit
- Dokumentet kontabël dhe financiare që do të auditoohen;
- Raportet financiare dhe operacionale;
- Regjistrimet nga sistemi i kontabilitetit të Handikos Ferizaj.

Auditori

- Këto terma reference dhe mandati përkatës për auditimin;
- Raportet e mëparshme të auditimeve të brendshme dhe të jashtme relevante.

Vendi i kryerjes së auditimit

- Auditimi do të zhvillohet në zyrat e Handikos Ferizaj Rruga "Zenun Beqa" Ferizaj Kosovë.

Koha e kryerjes së auditimit

- Auditimi do të kryhet gjatë muajit mars 2025.

Detyra dhe kontrolle specifike që do të kryhen

- Kontrolli i përgjithshëm:
- Verifikimi i ekzistencës së marrëveshjeve kontraktuale të shkruara me të gjitha organizatat partnere.
- Verifikimi i fondeve të pranuar për projektin.
- Verifikimi që mallrat e blera me fondet e alokuara janë përdorur për qëllimet e parashikuara dhe janë ende të disponueshme ose janë dhuruar/shitur në përputhje me metodat e përcaktuara në procedurat përkatëse të përcaktuara nga zyra qendrore dhe/ose nga kërkesat paraprake të donatorëve.
- Për të gjitha projektet e zbatuara nga vetë Handikos Ferizaj: verifikimi i shpenzimeve përmes ekzaminimit të dokumenteve mbështetëse, konfirmimit ose kombinimit të këtyre procedurave.
- Për projektet e zbatuara nga organizata partnere: verifikimi dhe shqyrtimi i pasqyrës financiare të audituar të organizatës zbatuese. Nëse nuk ka pasqyra financiare të audituara, verifikimi i raporteve të shpenzimeve të projektit nga partneri zbatues për çdo projekt.
- Verifikimi i të gjitha shpenzimeve të zyrës (pagat, qiraja e zyrës, shpenzimet e udhëtimit, dietat, përfitimet e sigurimeve shoqërore, etj.) përmes ekzaminimit të dokumenteve mbështetëse, konfirmimit ose një kombinimi të këtyre procedurave.
- Verifikimi që kontratat lokale (kontratat e punësimit, qiradhënies dhe konsulencës) janë në përputhje me legjislacionin lokal në fuqi.
- Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve, proceseve ligjore dhe rezervave. Gjetjet duhet të përfshihen në Memorandumin Përmbledhës Final.
- Verifikimi i procedurave të menaxhimit në lidhje me transaksionet e ndryshme dhe aplikimi i tyre. Në veçanti, verifikimi i ndarjes së kompetencave dhe përgjegjësi (angazhimet, regjistrimi i shpenzimeve, pajtimi i arkës, etj.), duke vlerësuar efikasitetin e tyre dhe duke raportuar dobësitë e zbuluara.
- Verifikimi i transaksioneve të projektit në aspektet e mëposhtme:
- Pajtueshmëria e autorizimeve të shpenzimeve dhe vlefshmëria e dokumenteve mbështetëse.
- Saktësia aritmetike e llogarive, dokumenteve mbështetëse dhe pasqyrave financiare.
- Saktësia e regjistrimeve kontabël.
- Alokimi i shpenzimeve në përputhje me buxhetet.
- Kontrolli i avanseve, rezervave të akumuluar, detyrimeve të prapambetura dhe përmbylljeve të projekteve.
- Alokimi i shpenzimeve në përputhje me kontratat e donatorëve.
- Çdo verifikim tjetër që auditori mund ta konsiderojë të dobishëm në ekzekutimin e mandatit të tij.
- Zhvillimi ekonomik i biznesit – vlerësimi i fushave/masave të mëposhtme:
- Procesi i prokurimit: verifikimi i ekzistencës dhe respektimit të procedurave të blerjes.
- Bashkëpunimi me ekspertë vendorë (ligjorë, tatimorë, etj.).
- Verifikimi i kontratave lokale për të siguruar që janë në përputhje me legjislacionin lokal në fuqi.
- Auditimi specifik mbi partneritetet lokale – Zyra e lidhjes me partnerët:
- Verifikimi i ekzistencës dhe respektimit të udhëzimeve të Handikos Ferizaj. Si funksionon ky proces? Si kryhen kontrollet?
- Procesi i përzgjedhjes së partnerëve: vlerësimi nëse partneri është i përshtatshëm dhe i besueshëm për Handikos Ferizaj (menaxhimi i programit, korniza e performancës, prokurimi & financat, kushtet shtesë, raportimi, etj.).
- Lidhur me marrëveshjet: rishikimi i kushteve të përgjithshme mbi bazën e të cilave fondet janë vënë në dispozicion, përfshirë mënyrën dhe kohën e disbursimit, kërkesat e prokurimit dhe raportimin financiar që partneri duhet të përmbushë.

- Proceset e disbursimit dhe kontrollit: shqyrtimi i përditësimeve të progresit dhe kërkesave për disbursim. Kush shqyrton buxhetin (shpenzimet dhe balancën e parasë), indikatorët (monitorimin & vlerësimin dhe prokurimin) dhe kryen një rishikim kontekstual.

Kontrolli përfundimtar:

- Verifikimi që të gjitha korrigjimet e kërkuara nga auditimet e mëparshme janë zbatuar.
- Verifikimi i regjistrit të automjeteve dhe që çdo përdorim privat i mundshëm është faturuar dhe paguar.
- Pajtimi i bilancit bankar dhe të arkës me bilancin kontabël.
- Verifikimi i raportit të auditimit Saga sipas monedhës dhe certifikimi i secilës monedhë.
- Raporti i rekomandimeve/Letra e menaxhimit duhet të përfshijë përgjigjen e menaxhmentit të Handikos Ferizaj për çdo çështje të ngritur.

Raporti i auditimit

Raporti i auditimit të draftit

Auditori pritët të përgatisë një draft raport auditimi, duke identifikuar gjetjet dhe rekomandimet, i cili do të ndahet me Handikos Ferizaj për diskutim dhe shqyrtim. Stafi i Handikos do të ketë 10 ditë pune për të dhënë komente, për të kundërshtuar ose për të pranuar raportin e draftit. Për këtë qëllim do të organizohet një takim.

Raporti përfundimtar i auditimit

Auditori pritët të përgatisë një raport auditimi mbi pasqyrat financiare të Handikos Ferizaj i cili do të bazohet në Parimet e Përgjithshme të Kontabilitetit të Pranuara dhe monedhën EUR. Në këtë raport, auditori pritët të shpjegojë dhe të sqarojë çdo rregullim dhe/ose riklasifikim të hyrjeve kontabël.

Letra e rekomandimeve/menaxhimit

Raporti duhet të përfshijë një letër rekomandimesh për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm (ICS) si dhe të procedurave të projektit dhe kontabilitetit.

Përmbajtja dhe struktura e raportit të auditorit:

- Opinioni i auditorit (duke adresuar katër parimet kryesore të përmendura më sipër).
- Emri i projekteve, donatorëve, partnerëve, përfshirë çdo nënkontraktor.
- Përshkrim i shkurtër i informacionit relevant (historia, menaxhimi, sistemi i kontabilitetit, sistemi i kontrollit të brendshëm, etj.).

Periudha e mbuluar nga raporti.

- Data dhe vendi i rishikimit, emri i firmës audituese, devijimet nga programi fillestar i rishikimit.
- Përshkrimi i procedurave të auditimit të aplikuara dhe gjetjet mbi informacionin financiar të audituar.
- Analiza e fondeve të pranuar nga donatorët e tjerë, nëse është e aplikueshme.
- Komente mbi pajtueshmërinë me marrëveshjen/kontratën e projektit dhe termat e referencës.
- Krahasimi i buxhetit të projektit, përfshirë komentet mbi devijimet kryesore.
- Procesverbali i takimit përmbysllës.
- Gjetjet dhe rekomandimet mbi menaxhimin e projektit, procedurat e kontabilitetit dhe sistemin e kontrollit të brendshëm (ICS).
- Shpenzimet e kryera gjatë vitit 2024 ose shpenzimet e bëra gjatë vitit 2024 janë rreth **300,000.00 EUR**.

Nënshkrimi

Raporti i auditimit duhet të nënshkruhet nga një përfaqësues i auditorit si dhe nga udhëheqësi i ekipit të auditimit dhe duhet të jetë në shqipe.